



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1697 prot.

Fushë-Arrëz, më 17.06.2025

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz,

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 16.06.2025, njoftoheni se mbledhja radhës e Këshillit Bashkiak për muajin **Qershor 2025**, zhvillohet ditën e **Enjte, datë 26.06.2025, ora 10:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.06.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Maj 2025.
4. Projektvendim për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së 2026-2028.
5. Projektvendim për dhënien e dakordësisë për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore publike prej 0.0719 ha për kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për shoqërinë “Uji Puka” Sh.P.K në zonën kadrastale me nr.1657 dhe nr.2686, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz". (Rishqyrtim i Vendimit Nr.56, datë 28.10.2024)
6. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
7. Të ndryshme.

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE:

- Mbledhja e Komisionit të Mirëqenjes Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda ,Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën e **Mërkurë**, datë **25.06.2025**, ora **10:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **3** të rendit të ditës.
- Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, (**Franc Doda, Valentin Doçi, Valentina Lleshaj, Besjana Marku, Zef Cara**), ditën e **Mërkurë**, datë **25.06.2025**, ora **10:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit, për pikën **4**, të rendit të ditës.
- Mbledhja e Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (**Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa**) ditën e **Mërkurë**, datë **25.06.2025**, ora **11:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **5** të rendit të ditës.

Duke ju falenderuar, njëkohësisht kërkoj korrektësinë tuaj për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

